

Data 24.05.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL
LEZHË”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42716000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 27,782,667 (njëzetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Perqëndruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Certifikata duhet të jetë e

lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të tillë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit pra Ak-së. Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi është pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përputhje të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përputhje të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtrun veprimtarinë për kyerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronësi/qira/përdorim

Vendodhja që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

- Krahas deklaratës të paraqesë akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Shënim 2.1:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues për ambientin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posaçme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se

shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderia, pra operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e shërbimit të lavanderisë. Për për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të provojnë se disponojnë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

3. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të **Tipit B “Pastrim kimik”**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht: 5 (pesë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Staffi	Nr.
a)	Drejtues Teknik	1 (një)
b)	Punëtore në Lavanderi	3 (tre)
c)	Shofer	1 (një)
	Totali i punonjësve	5 (pesë)

- a) Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqes:
 - Kontrate individuale pune për drejtuesin teknik;
 - Diplomen përkatëse;
 - Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.
 - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - Albania.
- b) Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, te paraqitet vetëm kontrate pune përkatëse.
- c) Për punonjësit Shofer të paraqitet Leje Drejtimi në përputhje me mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Kodi i deklaramit ne Liste Page	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesin dokumentacionin e mësipërm të kërkuar të çdo punonjësi pranë AK.

***Shenim 4.1:**

Me qëllim garantimin e gjithë përfshirjes, për të dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik nënkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor, Spitali Rajonal Lezhë, referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbimi i lavanderie ka përcaktuar një numër minimal punonjësish në funksion të ofrimit të këtij shërbimi nga operatorët ekonomik-. Duke qene se është kontratë 2 (dy) vjeçare dhe referuar volumit të shërbimit i cili parashikohet të realizohet, kërkohet që ofertuesit duhet të vërtetojnë që kanë të punësuar fuqi punëtore minimale në sektorin e shërbimit të objekt prokurimi. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar numri i punonjësve sipas profesioneve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve.- Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojën per kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes per realizimin e objektit.

5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makine larese Profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
2	Makine Pastrimi Kimik Profesionale (për jorgan vatine dhe jastek, me kapacitet mbi 20 kg)	Cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
3	Makine tharese profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK	Në pronësi ose me qira
4	Makine Hekurose (Rul) Profesionale (mbi dy metra gjatesi)	Copë	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
5	Peshore Elektronike mbi 100 kg	Copë	1 (nje)	Në pronësi ose me qira

Shënim 5.1:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesin prane AK dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, Dqë vërtetojnë se, këto pajisje dhe insntumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit te dokumentacionit te mesiperm, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, do te verifikoj

prane ambienteve te operatorit ekonomik fitues disponueshmerine e pajisjeve te deklaruar.

Pajisjet e kerkuara qe do te deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Është e nevojshme disponimi i mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës dhe konkretisht se disponojnë ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së larjes së materialeve të buta, ambient i cilin duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi provuar ky fakt me paraqitjen e dokumenteve të mësipërme.

7. Operatori ekonomik ne lidhje me materialet e pastrimit qe do te perdoren per sherbimin e lavanderise e percaktuar ne specifikimet teknike, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Materialet e Buta			Spitali Rajonal Lezhë
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
3			
Etj.			

Shënim:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Ne varesi te ndotjes dhe rrezikshmerise qe kane materialet spitalore, operatori ekonomik duhet të garantoj se per sherbimin e lavanderise do te perdor detergjent dhe dizinfektant lares sipas standarteve higjieno -sanitare te certifikuara nga organe te akredituara. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar lloje e materialeve të ndotura qe do te lahen, per te cilen operatori ekonomik duhet te specifikoj vendin e origjines se laresve si dhe akreditimin e saj.

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targen e mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi ose me qira

Shënim 8.1:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacion per mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimi të mjetit.

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte per skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Është e nevojshme disponimi i mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Operatorët ekonomike duhet të disponojnë të paktën 1(një) mjet transporti mallrash, , të cilat duhet ti kenë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin të kërkuar në këtë kriter. Mjeti transportitues është I nevojshem për transportimin e materialeve të buta nga lavanderia në ambientet e Spitalit Rajonal Lezhë dhe anasjelltas. Kapacitetet teknike të mësipërme janë të domosdoshme për realizimin me sukses te kontratës objekt prokurimi.

9. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate operatori ekonomik duhet të garantoj së shërbimi I lavanderisë do të kryhet sipas standarteve në fuqi me qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **14/06/2023**; Ora: **11:00**; Vendi: www.app.gov.al, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë